LEXUESHMËRIA DHE LËVIZSHMËRIA

Duke krijuar ambiente, objekte, rrugë, nyje të dallueshme dhe të njoura të cilat na
udhëzojnë dhe orjentojnë.
Duke krijuar hapësira të cilat lidhen mes veti me lehtësi

ADPTABILITETI

Duke krijuar sisteme dinamike të venbanimeve të cilat adaptohen lehtë ndryshimeve
ekonomike, sociale, teknologjike të tregut...

DIVERSITETI

Duke promovuar përmbajtje mikste
Duke promovuar përmbajtje komplementare të cilat përkrahin njëra tjetrën

INTEGRIMI DHE SINERGJIA

Duke integruar banimin, punën dhe rekreimin
Duke zvogluar distancat dhe integruar transportin
Duke integruar vlerat ambientale

Projektimi me tipare lokale nënkupton pajtim me praktikën lokale, në njërin anë, dhe
nevojat në anën tjetër me teknologjinë më të re, tipet e ndërtesave.



Nuk ka arsye që karakteri dhe inovacionet të mos korespondojnë në mes vedit duke mos e penguar njëri tjetrin, nëse dizajni I të resë I referohet qëllimeve të dizajnit urban.

Forma tridimensionale e pejsazhit natyror është bazë për formën e ansambleve urbane (e shprehur në planimetrinë dhe vëllimet e tyre). Vecantitë natyrore mund të ndihmojnë në formësimin e një ansambli të ndërtesave dhe ta integrojnë ato në zonën e gjërë duke kontribuar për kuptimin e hapësirës.

INTEGRIMI DHE SINERGJIA

- Planimetria, vëllimet dhe dizajni I pejsazhit të një ansambli mund të integrohet me sukses në pejsazhin e gjërë përmes mbjelljes, zonat e gjelbrimit izolues, indet e gjelbrimit dhe korridoret e gjelbërta përreth lumenjve, kanaleve dhe rrugëve.
- Forma dhe detajet e ndërtesave kontribuojnë në tiparet kualitative të një hapësire. Kjo mund të implementohet me sukses në ansamblet e reja, pa kufizim të mundësive të projektuesit. Zgjidhjet standarde rrallë janë të pranueshme nëse ato nuk janë në gjendje të krijojnë ansamble me identitet të shprehur ose shfrytëzim optimal të ndonjë hapësire
- Format lokale të ndërtesave ndojherë përfshijnë tippet e banesave, trajtimin e kufinjve, vijat ndërtimore, kulmet e pjerrta, tippet e dritareve dhe kopshtet
- Shkalla, textura dhe ngjyra e materialeve ndërmore reflekton funksionin specifik të zonës dhe karakterin.

Cdo element I skenës së rrugës I kontribuon identitetit të hapësirës-vendit, përfshirë skulpturave, ndricimit, gardhet, shportat, pllakosja, fontanat dhe mobiliari tjetër urban.

Në lokacionet e pjerrta, ndërtesat të cilat orientohen kah ramja e terrenit me hapje dhe transparencë të fasadave I kontribuojnë më shumë karakterit

Vëllimet e ansambleve kontribuojnë në krijimin e dominantave në siluetën e qyteteve dhe vendbanimeve, ose ato e respektojnë siluetën. Karakteri I siluetës është I komozuar nga vëllimet e masave, forma e kulmeve si dhe madhësia e ndërtesave.

Dallimi në mes të hapësirës publike dhe private nuk është fenomen natyror, por prodhim i kulturës së një vendi dhe kohe.

Rjeta e rrugëve formon hapësirën publike



Mënyra e vendosjes së rrjetit të rrugëve mund ta mbështesë shpejtësinë e vogël të trafikut të automjeteve.

Projektimi i rrjetit të rrugëve duhet të mbështetet në efektin e tyre ndaj shpejtësisë së qarkullimit.

Shpejtësia e qarkullimit mund të menaxhohet me organizimin e hapësirës dhe ndërtesave.

Qetësimi fizik i trafikut duhet të jetë sekondar, por të konsiderohet si pjesë integrale e dizajnit.

Planimetria dhe dendësia e ndërtimit ndikon në mundësinë e qasjes së transportit publik

Dendësia më e madhe është në favor të transportit publik, për shkak të numrit më të madh të shfrytëzuesve

Stacionet edhe терминаlet e integruara promovojnë shfytëzimin e transportit publik dhe siguron lëvizje të paanshmenë mes të llojeve të ndryshme të udhëtimit.

Zonat komerciale me dendësi të madhe dhe ato me përmbajtje të kombinuar dhe ndërtesa publike, me frekuencë të madhe të shfytëzuesve është më së miri të vendosen në afërsi të stacioneve të transportit publik.

Stacionet e dizajnuara si pjesë integrale e hapësirës publike krijojnë ambiente të sigurta për këmbësorët gjatë tërë ditës.

Rekomandim

- Objektet

Zhvillimi urban në formë të bllokut të mbyllur, mund të ndihmojë në krijimin e një ndarje në mes të hapësirës publike dhe private.

- Qasja

Daljet dhe tërheqjet nga vija ndërtimore si hajatet dhe hyrjet i japin qasje të vlefshme duke mos e anashkaluar kontinuitetin.

Aty kundërtesa tërhiqet nga vijat ndërtimore mund të krijohet hapësirë funksionale edhe atraktive për këmbësorë.

Ndërtimi i hyrjeve të cilat janë të karta i kontribuojnë perceptimit më të lehtë të hapësirës.



Gjatë projektimit të merret parasysh dhe të përcjellet morfologjia e terrenit dhe karakteri i lokacionit

Hyrjet janë aty ku njerëzit lëvizin në mes të hapësirës publike dhe private dhe krijojnë mundësinë e aktiviteteve publike.

- Fasada

Më pak hapësira private kah rruga-dhoma e ditës psh. posacërisht në përdhese ka përqëllim relacionin direkt me rrugën. Më shumë hapësira private kah rruga-dhoma fjetje spsh, tentojnë ta bëjnë të vdekur fasadën kah rruga. Ndërtesat të cilat ia kthejnë "shpindën" janë zakonisht me rrethojë të lartë rrugës. Bulevardi mundëson orientimin kah rruga ku qasja është e limituar.

- Oborret

Oborret e brendshme-private ose të përbaskëta janë më së miri të ndara me pjesëne prapme të ndërtesave.

Oborret prapa shtëpisë janë më të sigurta nëse kufizohen me oborret tjera-jo me rrugë ose shtigje të këmbësorëve.

Oborret e brendshme-jo publikeku dendësia e shfrytëzimit është e madhe, intimiteti në përdhese mund të ruhet me oborre private.

Ndërtesat në këndin e bllokut të mbyllur mund ta mbyllin vizuelisht këndin. Thellësia më e vogël e ndërtesave mund të aplikohet në kënd, për të lejuar insolim dhe ndricim më të mirë pa e prishur vijën e fasadës kontinueale të blloqeve të mbyllura. Oborret dhe distancat më të vogla mund të reduktojnë ose eliminojnë zbrastirat dhe muret e zbrastira të këndit të bllokut që poashtu e ngritë intimitetin.

Tërheqja e etazhave të fundit e zvoglon ndikimin e ndërtesës në rrugë duke i bërë kate të mësipërme më pak të dukshme nga rruga.

Tërheqja prapa mund të rrisë dendësinë pa e rritur dendësinë në kuptim të shkallës, por realisht ajo mund ta rrisë dendësinë e ndërtimit dhe ta pengojë dritën dhe insolim.

Artikulimi i kjarhtë i pronës private rreth ndërtesës-me rrethojë, mure, porta, harqe, shenja dhe pllakosje, për cakton kufinj të mes të hapësirës publike dhe asaj private.

Dizajni detal mund të përcaktojë se hapësirat si oborret para ndërtesave, tregjet, ose rrugë të mbuluara janë publike ose private.

Pejsazhi është pjesë e rëndësishme e identitetit lokal



Parcelat me gjërësi të vogël promovojnë fasada më aktive frontale, e rrisin sensin e të rrethuarjes dhe lejojnë dendësi më të madhe.

Shkalla, textura dhe ngjyra e materialeve ndërmore reflekton funksionin specifik të zonës dhe karakterin.

Rrugët e reja duhet të lidhen në rrjetën ekzisuese dhe vijat e lëvizjes. Shkalla e lidhshmërisë në zhvillimet e reja urbane është shpesh cels i suksesit.

Vendosja e shtigjeve të këmbësorëve, shkurtesave dhe rrugicave mund të jetë bazë për sigurimin e lidhjeve

Forma tradicionale e rrugëve kryesore, që lejon ndaljen, parkimin dhe trafikun e ngadalshëm, paraqet mënyrë efektive për mundësimin e trgtisë dhe aktiviteteve ekonomike lokale.

Krijimi i blloqeve të mëdha nuk është i volitshëm për shkak se i rritë distancat e ecjes dhe del jashtë përmasave të distancave të volitshme të ecjes.

Lëvizja këmbësorike është zakonisht më e këndshme nëpër rrugët tregtare me frekuencë të madhe.



7.3. Normativat e aplikueshme

NDARJA E SIPERFAQEVE SIPAS DESTINIMIT					HA	[%]
1	BANIMI [10%-20%]				12.3	15.6%
	Institucioni	Përshkrimi / komentetet	Standard i aplikueshem (ref: british, Italian)	Nr. Obj.	HA	
	objekte banimi	sipërfaqja bruto 150 m2/familje	18000 banorë/4000 familje			9.6
		komunikimi+ hapësirat e përbashkëta				2.7
2	SIP.E LIRA TË GJELBËRTA & FUSHËLOJAT, OBJ.SPORTIVE-REKREUESE [65%-80%]				55.0	69.6%
			18000:banorë			
2.1	Fushëlojat / trojet shkollore				8.4	10.6%
	Institucioni	Përshkrimi / komentetet	Standard i aplikueshem (ref: british, Italian)	Nr. Obj.	HA	
	fushëlojat në kuadër të trojeve shkollore	në 13 institucione shkollore, në kuadër të trojeve shkollore, me indeks të ndërtimit sipas tab.X	9 m2/ fëmijë për instit. Parashkollore 15m2 /nx. Për shk. Fillore 20m2/nx për shk. Mesme	13		6.9
	fushëlojat në kuadër të lagjeve					1.5
			18000:banorë			
2.2	Sporti, rekreimi, gjelbr.				24.5	
	Institucioni	Përshkrimi / komentetet	Standard i aplikueshem (ref: british, Italian)	Nr. Obj.	HA	
	Qendra e Rekreimit	Ndërtesë ose kompleks brenda Parkut të lagjes	1 lokacion /20,000 ban. Standardi: min.2ha < > min0.5m2/ban	1		1.8
	Pishina lokale (rekreative)	Ofron programe vjetore; ndodhet në Qendrën e Kulturës-Rekreimit ose në	1 lokacion / 20,000 banorë standardi 2: 0.3m2/ban	2		1
	Pishina e Mbyllur (gara)	Jo më pak se 25m gjatësi ME 3 metre board; përfshin hapësirë për spektatore; zakonisht e	1 lokacion / 20,000 banorë	1		1.5
	Plato për shumë qëllime	Në fqinjësi me shkollë, dimrit shfrytëzohet për natëjim	2 lokacione /10,000 ban.	2		0.3
	parqet lokale - ne zonat e banimit	standardi 0.4-0.9 ha/1000 ban, madhësia opt. 2.4 Ha		2.45	6	14.7
			18000:banorë			
2.3	Sipërfaqet e lira				16.1	
	Institucioni	Përshkrimi / komentetet	Standard i aplikueshem (ref: british, Italian)	Nr. Obj.	HA	
	sipërfaqet e gjelbruara ne kuader te parcelles se banimit	23.6 ha sipërfaqe totale per banim: standardi: 50% toke ndërtimore < > 50% gjelbrim				11.8
	sipërfaqe tjera të lira					4.3
2.4	varrezat				5.5	
	Institucioni	Përshkrimi / komentetet	Standard i aplikueshem (ref: british, Italian)	Nr. Obj.	HA	
	Varrezat	1.5-2m2 / ban; kohëzgjatja 50 vite. (në rastin konkret është tejkualuar.)	konzervim	1		5.5



NDARJA E SIPËRFAQEVE SIPAS DESTINIMIT					HA	[%]
3. OBJEKTET PUBLIKE [3%-5%]					4.8	5.7%
					18000 banorë	
3.1	Arsimi			cca	1.9	2.3%
	Institucioni	Përshkrimi / komentetet	Standrard i aplikueshem (ref: british, Italian)	Nr. Obj.	HA	
	Entet Parashkolore	Standrardi 1 Inst. Parashk. me nga 3 njësi me 70 fëmijë /2500 ban => 1 inst. Parashkolor =cca 200 fëmijë	Ndërtesë 2.3 m2/fëm. Trolli 1 instit. Parash 9m2/fëm. Shputa e ndërtimit max 20%	6	0.4	
	Sh. Fillore	1 shkolle f/1ndërrim/800nxënës, në dy etazhe * (nr. Nx. sipas piramidës së grupmoshave)	Ndërtesë shkollore 5m2/nx. Trolli shkollior 15 m2/nx Shputa e ndërtimit max 25%	5	1.00	
	Sh. Mesme / profesionale	2 shkolle f/1ndërrim/1000nxënës, në tri etazhe * (nr. Nx. sipas piramidës së grupmoshave)	Ndërtesë shkollore 5m2/nx. Trolli shkollior 15 m2/nx Shputa e ndërtimit max ___%	2	0.6	
					18000 banorë	
3.2	Kultura			cca	0.6	
	Institucioni	Përshkrimi / komentetet	Standrard i aplikueshem (ref: british, Italian)	Nr. Obj.	HA	
a	Qendra e Kulturës	Ndërtesë ose kompleks multidiciplinar brenda Parkut të Zonës Urbane	1 lokacion /20,000 ban.	1	0.1	
b	Biblioteka Lokale	Sistemi integral është esencial për çdo qytet; mund të jetë e kombinuar me system shkollior, system të kulturës (në Qendrat e kulturës).	1 lokacion /20,000 ban. përfshirë bibliotekat satelite	1		
c	Galeri	në kuadër të Qendrës së Kulturës ose e integruar në sheshe banimi		1		
d	Kinema	në kuadër të Qendrës së Kulturës ose e integruar në sheshe banimi		1	0.5	
					18000 banorë	
3.3	Shëndetësia			cca	0.1	
	Institucioni	Përshkrimi / komentetet	Standrard i aplikueshem (ref: british, Italian)	Nr. Obj.	HA	
	QFM	100 vizita ditore / 5mjekë + 1		550	2	0.1
					18000 banorë	
3.4	Tregtia, Afarizmi			cca	1.8	
	Institucioni	Përshkrimi / komentetet	Standrard i aplikueshem (ref: british, Italian)	Nr. Obj.	HA	
	Qendra Tregëtare, ose dyqane	standardi: 0.5-1.5m2/banore pervetesohet 0.5m2/banorë		0.5	2	1.8



NDARJA E SIPERFAQEVE SIPAS DESTINIMIT		HA	[%]
3. OBJEKTET PUBLIKE [3%-5%]		4.8	5.7%

18000:banorë

3.5 Shërbimet publike (në kuadër të Zonave të Banimit) cca 0.4

Institucioni	Përshkrimi / komentetet	Standrard i aplikueshem (ref: british, Italian)	Nr. Obj.	HA
a	Qendra e Administratës Lokale	Përmbajnë hapësira të nevojshme për një Njësi Administrative:	2	
b	Shërbimi Postar / Telekomunikacioni	Hapësirë në kuadër të ndonjë objekti public ose ndërtësë e veçantë (kryerja e shërbimit të PTT)	1	
c	Shërbimi Bankar	Hapësirë në kuadër të ndonjë objekti publik ose ndërtësë e veçantë, ose punkt /bankomat	2	
				cca 2000 m2 në dy etazhe*18000 ban./10000:
d	Shërbimi i Sigurisë Civile	Stacioni i zjarrfikësve i lidhur me shërbimin e Emergjencës Medikale	1	0.07
e	Shërbimi Policor	Stacionet policore lokale në rrjet me Njësitin e Zjarrfikësve dhe Emergjencën Medikale	1	0.07
f	Tregu lokal	Hapësirë e veçantë ose e integruar në sistemin e shoppingut (oborri/sheshi i shopping qendrës)	2	0.09

4 RRUGET/PARKINGJET E BANIMIT, SHTIGJET, SHESHET/OBORRET EKONOMIKE [8%-12%]		23.74
--	--	--------------

18000:banorë

4.1 Rrugët, sheshet cca 6.9

Institucioni	Përshkrimi / komentetet	Standrard i aplikueshem (ref: british, Italian)	Nr. Obj.	HA
	Rrugët kryesore	2.6m2/banorë	n/a	4.7
	sheshet	1.2m2/banorë	n/a	2.2

18000:banorë

4.2 Parkingjet cca 5.0

Institucioni	Përshkrimi / komentetet	Standrard i aplikueshem (ref: british, Italian)	Nr. Obj.	HA
	Parkingjet	standardi: 0.3 vendparkim / 1banor standardi: 2 vendpark/1familje 4.5 anetareshë	2	5.0

GJITHSEJ		84	100.00%
-----------------	--	-----------	----------------



8. TRAFIKU DHE TRANSPORTI PUBLIK

Rrugët e reja në zonën e Planit Arbëria 3 janë projektuar duke e respektuar konfiguracionin e terrenit i i cili, jo gjithmonë është lehtë i përballueshëm. Gjatë projektimit të rrugëve të reja, është konsideruar hierarkia e modaliteteve e që nënkupton përfshirjen sipas prioritetit të të gjithë pjesëmarrësve në trafik. Në këtë kontekst, janë vendosur parimet programore për shtigjet e reja të këmbësorëve dhe të ciklistëve si dhe të transportit publik urban dhe të parkimit publik.

8.1 Hierarkia e modaliteteve

Qëllimi parësor i këtij Plani lidhur me trafikun është që të mundësojë shfrytëzim maksimal të rrugës dhe të rrjetit rrugor nga të gjithë shfrytëzuesit. Trafiku i Integruar do të mundësojë shfrytëzim të transportit publik nga të gjitha modalitetet e lëvizjes me potencim tek këmbësorët dhe ciklistët. Këtu gjithashtu përfshihet transporti i përshtatshëm me vetura paralelisht me masat për restriksione dhe menaxhim të trafikut rrugor aty ku një gjë e tillë shfaqet si e nevojshme. Nevoja për lloje të ndryshme të transportit do të konsiderohet përballë hierarkisë së modaliteteve të cilat promovojnë përfshirje sociale për të gjithë banorët:

- 1) Këmbësorët, përfshirë personat me vështirësi në të lëvizur (me aftësi të kufizuara fizike);
- 2) Çiklistët ;
- 3) Shfrytëzuesit e transportit publik (autobusi urban, përfshirë taksitë shërbimin)
- 4) Shfrytëzuesit e bizneseve komerciale (në kuadër të zonave mikes)
- 5) Vizitorët dhe banorët e Arbërisë 3 që lëvizin me vetura;

Hierarkia e modaliteteve do të përdoret për t'u siguruar përparësi atyre modaliteteve që ndodhen në majë të hierarkisë në ato raste kur nuk ekziston mundësia që të akomodohen të gjitha modalitetet në mënyrë të kënaqshme.

8.2 Shtigjet e reja për këmbësorë

Në rrjedhë me hierarkinë e modaliteteve, shtigjet për këmbësorë duhet të konsiderohen si prioritarë në raport me të gjitha ndërtimet e reja, gjë që ndihmon në promovimin e ecjes si mjet primar të lëvizjes për rrugëtime të shkurtëra, si brenda Arbërisë 3., ashtu edhe për në zonat fqinje të saj, me potencim në lidhjet këmbësorike për në qendër të qytetit të Prishtinës. Prandaj, do të kërkohet që të gjitha zhvillimet të ofrojnë qasje të përshtatshme, të këndshme dhe të sigurtë për këmbësorë, e që nënkupton shenjëzim dhe ndriçim të shtegut si dhe shtruarje të sipërfaqes së shtegut në mënyrë adekuate. Gjithashtu, duhet konsideruar edhe ndërmarrjen e masave që e ndihmojnë lëvizjen dhe



dukshmërinë për personat me pengesa gje që mundëson që rrugët në përhgjithësi të jenë më të sigurta dhe më të përshtatshme

8.3 Shtigjet e reja për çiklizëm

Të gjitha zhvillimet duhet të ofrojnë qasje të përshtatshme, të sigurtë dhe të këndshme edhe për biçikleta. Çiklizmi ka potencial që t'i zëvendësojë udhëtimet e shkurtëra me veturë. Është e rëndësishme që çiklizmi të bëhet më atraktiv për rrugëtime të shkurtëra të cilat përndryshe do të bëheshin me vetura. Gjithashtu është e nevojshme që të krijohet rrjeti i shtigjeve të çiklizmit në qytet në mënyrë që të inkurajohet kjo formë e transportit edhe për qëllime të argëtimit dhe të rekreimit. Kur këto shtigje janë të përbashkëta edhe për këmbësorët, ato do të dizajnohen në favor të sigurisë për këmbësorët, e në veçanti për të verbërit.

8.4 Transporti publik

Përfshirja sociale përmes transportit publik është një faktor i rëndësishëm që e ndihmon rregullimin e trafikut në mënyrë të qëndrueshme. Aktualisht, në Prishtinë është i aktivizuar trafiku urban i cili kryesisht qarkullon nëpër rrugët kryesore të qytetit, ndërkaq transporti publik më frekuentiv realizohet përmes kombi-busëve të cilët në situata të caktuara paraqesin pengesë në kontekstin e shfrytëzimit racional të rrugëve. (krijojnë bllokada në rrugë, por kanë edhe kualitet shumë të dobët të shërbimeve të transportit).

Që të mundësohet rrjeti gjithpërfshirës i trafikut publik në lidhje me integrimin e Arbërisë 3 me pjesët tjera të qytetit, është me rëndësi që të promovohen linja të reja të autobusit urban të cilat ofrojnë më shumë shërbime lokale. Linjat e propozuara të trafikut urban do të implikojnë edhe kërkesat për zhvillimet madhore të cilat duhet të kujdesen që të sjellin udhëtarët e autobusëve dhe të taksi veturave sa më afër hyrjeve të ndërtesave të reja dhe që të ofrojnë shërbime të kualitetit të lartë për pritje.

8.5 parkimi publik

Parkimi publik do të sigurojë parkim të përshtatshëm afat-shkurtër dhe të nevojshëm për mirëvajtje komerciale në zonave mikse të Arbërisë 3. Shërbimet për parkim të çikletave do të kërkohen në të gjitha zhvillimet e reja bashkë me parkimin për persona me aftësi të kufizuara, i cili duhet të ketë lidhje të mira me strukturat e reja urbane. Janë propozuar zgjidhjet si:

- Parkingje në të hapur (oazat)
- Parkingje përkaj rrugës (shiritet) dhe
- Parkingje nëntokësore dhe etazhe parkuese në ndërtesat madhore të zonave mikse



8.6. Hierarkia dhe Profilet e rrugëve

Sistemi i trafikut është projektuar duke shfrytëzuar hierarkinë e rrugëve si rrugë kryesore dhe përmbledhëse të zonës së planit. Që ky sistem të jetë në përputhje me modalitetet e lëvizjes, është bërë porpozimi për menaxhim të trafikut përmes vendosjes së limitit për shpejtësi të lëvizjes gjë që do të ndihmojë në uljen e shpejtësinë së trafikut në ato zona ku kërkesë prioritare është sigurimi i shtigjeve të sigurta për këmbësorët. Rrugët e reja do të ndërtohen konform rregullave mbi kriteret teknike për ndërtimin e rrugëve publike, të nxjerra nga Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit. Qasja prej një kategorie në kategorinë tjetër të rrugës është siguruar përmes udhëkryqeve në të cilat do të aplikohet përparësia e kalimit, ndërkaq pikëprerjet e rangut të njerjtë të rrugës do të realizohen përmes udhëkryqit rrethor.

Rruga e kategorisë [K1]

Gjerësia e rrugës: 2 kursorë me nga 3.50m

Gjerësia gjithsej: L = 16.2 – 17.0 m

Shpejtësia e lëvizjes: 50(40)km/h




Fig. 1. Prerja tërthore e rrugës tipike [K1]

Rrugët e katogorisë K1 janë rrugët hyrëse-dalëse për në zonën e planit si dhe rruga unazore kalon përreth tërësisë Urbane Qendra. Vatësisht nga modaliteti i parkingjeve në varg të parapara përgjatë profileve të këtyre rrugëve, K1 është koncipuar si:

- Rrugë pa parkim gjatësor
- Rrugë me oaza parkimi në njerën anë
- Rrugë me oaza parkimi në të dy anët



Më poshtë është e dhënë tabela e variteteve të rrugës K1, në varësi me destinimin e zonave fqinje:

Profillet e rrugës K1 varësisht nga destinimi i zonave fqinje						
Zona fqinje 1		Zona fqinje 2		K1	gjerësia [M]	Profili I rrugës
A	banim I ultë	A	banim I ultë	Rruga: Gjelbrim: Cikletat: Këmbësorët: Gjithsej	2 x 3.5 m 2 x 2.0 m 1 x 1.6 m 2 x 1.8 m 16.20 m	
C	zonë mikse	B	kryesisht banim	Rruga: Gjelbr/parkim: Gjelbrim: Cikletat: Këmbësorët: Gjithsej	2 x 3.5 m 1 x 2.4 m 1 x 2.0 m 1 x 1.6 m 2 x 1.8 m 16.60	
A A G E D D D	banim I ultë banim I ultë administra kryesisht banim parku I qytetit parku I qytetit parku I qytetit	B E B B F G B	miks kryesisht banim kryesisht banim kryesisht banim varrezat administra kryesisht banim	Rruga: Gjelbr/parkim: Cikletat: Këmbësorët: Gjithsej	2 x 3.5 m 2 x 2.4 m 1 x 1.6 m 2 x 1.8 m 17.0 m	
C D	zonë mikse parku I qytetit	C D	zonë mikse parku I qytetit	Gjithsej	17 m	Vërejtje: shtegu i ciklistëve kalon në anën tjetër të rrugës



Rruga e kategorisë [K2]

Gjerësia e rrugës: 2 kursorë me nga 3.25m

Gjerësia gjithsej: L= 15.5 m

Shpejtësia e lëvizjes: 50(40)km/h




Fig. 2 Prerja tërthore e Rrugës tipike [K2]

Rrugët e kategorisë K2 janë rrugët ndërlidhëse për në zonën e planit, të cilat e bëjnë shpërndarjen e komunikacionit prej kategorisë së rrugëve K1 në rrugët lokale të blloqeve urbane (K3) Vatësisht nga modaliteti i parkingjeve në varg të parapara përgjatë profieve të këtyre rrugëve, K2 është koncipuar si:

- Rrugë pa parkim gjatësor
- Rrugë me oaza parkimi në njerën anë
- Rrugë me oaza parkimi në të dy anët

Më poshtë është e dhënë tabela e variteteve të rrugës K2, në varësi me destinimin e zonave fqinje:



Profilet e rrugës K2 varësisht nga destinimi i zonave fqinje						
Zona fqinje 1		Zona fqinje 2		K2	gjerësia [M]	Profili I rrugës
A	banim I ultë	A	banim I ultë	Rruga: Gjelbrim/parkim: Këmbësorët: Gjithsej	2 x 3.25 m 2 x 2.4 m <u>2 x 1.2 m</u> 13.70 m	
A	Banim I ultë	D	Parku i qytetit	Rruga: Gjelbr/parkim: Gjelbrim: Cikletat: Këmbësorët: Gjithsej	2 x 3.25 m 1 x 2.4 m 1 x 2.0 m 1 x 1.6 m <u>2 x 1.2 m</u> 16.10	
E E E E D	kryesisht banim kryesisht banim kryesisht banim kryesisht banim parku I qytetit	B E D D	Destinim miks kryesisht banim Park-shkollë parku I qytetit parku I qytetit	Rruga: Gjelbr/parkim: Cikletat: Këmbësorët: Gjithsej	2 x 3.25 m 2 x 2.4 m 1 x 1.6 m 2 x 1.2 m 16.5 m	

Rruga e kategorisë [K3]

Gjerësia e rrugës: 2 kursorë me nga 3.0m
 Gjerësia gjithsej: L= 8.40 m
 Shpejtësia e lëvizjes: 30(20)km/h




Fig. 3 Prerja tërthore e Rrugës tipike [K3]

Rrugët e katogeorisë K3 janë rrugë lokale të kategorisë së tretë të cilat bëjnë degëzimin në nënzonat e planit. Këto rrugë janë projektuar si rrugë me dy kursorë pa mundësi të parkimit gjatësor



9. INFRASTRUKTURA TEKNIKE



10. PEIZAZHI DHE MJEDISI

Sipas Planit Strategjik-Zhvillimi Urban i Prishtinës, çështjet peizazhore dhe mjedisore janë komponentë e rëndësishme planifikuese dhe në kontekstin e planeve rregulative, të cilat duhet të ofrojnë mundësi për definimin e potencialeve peizazhore.

10.1. DEFINIMI I ZONAVE TË GJELBËRTA

Krahas definimit të zonave të reja ndërtimore është bërë identifikimi i potencialeve hapësimore në Zonën e Arbërisë 3 duke rezultuar me një peizazh urban i cili qytetarëve të ardhshëm do t'i sigurojë hapësirat e reja të gjelbruara dhe ekologji urbane. Krijimi i zonave për aktivitete në të hapur për qytetarët e Prishtinës do të kontribuojë në zhvillim e qytetit në një „Qytet të Gjelbër“. Ky program mjedisor kushtëzon ndërtimin e zonave të reja në Arbëria 3 konform legjislacionit në fuqi (Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji i Ndërtimit) dhe normave evropiane (EN) dhe standardeve ndërkombëtare (ISO), në vecanti standardi për arritje të cilësisë së kualitetit, të cilat pritet të harmonizohen për kushte të Kosovës nga Agjencioni për Standardizim i Kosovës.

Në këtë drejtim, Kuvendi Komunal i Prishtinës vendos prioritetin për zonën e Planit Arbëria 3 për mbjelljen e drunjëve dhe gjelbrimit të ultë si dhe menaxhimin efikas të tyre. Krijimi i institucionit nga ana e MMPH që do të bëjë matjen e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës, përfundimisht do të vendosë bazën për implementimin e Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit. Vetëdijësimi i popullatës në të gjitha nivelet arsimore dhe sociale lidhur me mbrojtjen e resurseve natyrore paraqet edhe një komponentë të rëndësishme në krijimin e kushteve më të mira ekologjike në Arbërinë 3.

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

Propozimet dhe projektet për zhvillimet e ardhshme në Arbëria 3 të cilat mund të kenë rëndësi të konsiderueshme mjedisore do të përfshijnë edhe Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (NMV) përmes së cilës do të identifikohen saktësisht efektet e lartpërmendura duke dhënë shpjegime lidhur me planin zhvillimor për mbrojtjen e karakteristikave natyrore të Arbërisë 3 dhe mjetet e përshtatshme për këtë qëllim, si dhe alternativat e zhvillimit.

Shfrytëzimi ekonomik i resurseve natyrore

Në dobi të shfrytëzimit sa më ekonomik të resurseve natyrore, në zonën Arbëria 3 do të inkurajohen ato zhvillime të cilat propozojnë për shfrytëzimin sa më të vogël të burimeve kryesore, duke përkrahur projektet për konservim të energjisë si dhe eksplotim të



energjisë alternative, krahas shfrytëzimit të integruar të ngrohjes dhe të energjisë, sidomos në blloqet e banimit kolektiv.

Poashtu do të inkurajohen ato zhvillime dhe biznese të cilat do të ofrojnë mundësinë për ndërlidhje të shërbimeve dhe mjeteve për reciklim të ujit dhe të hedhurinave, të cilat shërbime do të jenë qenësore në ndërtimin e blloqeve të qëndrueshme të banimit dhe të veprimtarive ekonomike-shërbyese në kuadër të zonave të reja të banimit.

Rizhvillimi i hapësirave publike dhe atyre private për qëllime të rekreimit dhe sportit në të hapur dhe në të mbyllur

Ndryshimi i destinimit ose rihvillimi i zonave ekzistuese duhet të përfshijnë propozime alternative ashtu që të plotësojnë kërkesat funksionale të destinimit të caktuar me këtë Plan Regullues. Propozimet e reja për këto qëllime duhet të kontribuojnë në karakterin e zonës në përgjithësi. Propozimet që rezultojnë me humbje të sipërfaqeve për rekreim do të jenë të pranueshme vetëm nëse dëshmohet se propozimi (destinimi) alternativ do të bëhet në afërsi dhe që i njëjti i plotëson kërkesat funksionale të destinimit të ndërruar dhe të shfrytëzuesve të tij;

Zhvillimet e reja të sportit dhe rekreimit

Zhvillimet e reja për qëllimin e cekur do të ballafaqohen me kërkesën reale lidhur me numrin, llojin, lokacionin dhe projektin e zhvillimeve të reja. Kjo nënkupton koordinimin e të gjitha programeve dhe shërbimeve të cilat mund të jenë publike, private dhe komerciale, si dhe vlerësimin e potencialit për sport dhe rekreim nga ana e qytetarëve. Në këtë mënyrë do të bëhet shfrytëzimi i plotë i kapacitetit të kësaj infrastrukture. Në funksion të realizimit më efikas, do të shfrytëzohen parametra për radiusin e shtrirjes dhe numrin e strukturave, që janë të ngjashme në nivel të qytetit.

10.2. PEIZAZHI URBAN, SPORTI DHE REKREIMI

Në kuadër të "Sistemit të Brendshëm të Qytetit" të planifikuar me PS-ZHUP, janë paraparë sipërfaqe të gjelbëruara në të hapur të karaktereve të ndryshme në formë të "Parqeve të Lagjeve", Parkut të qytetit, sipërfaqeve të pllakosura dhe shesheve identifikuese si dhe bulevardit, rrugëve të tjera kryesore (K1) dhe shtigjeve këmbësorike të cilat do të mundësojnë që njerëzit të kenë lëvizje më të relaksuar.

Meqë planifikimi, ndërtimi dhe operacionalizimi i infrastrukturës së sportit dhe rekreimit publik paraqet një përgjegjësi të madhe dhe kërkon investime kapitale, ky plan inkurajon shtrirjen e këtyre aktiviteteve në kuadër të një sistemi i cili do të ofronte sipërfaqet e nevojshme për qëllime sporti dhe rekreimi duke filluar prej qelulës së banimit e deri në nivel të gjithë hapësirës së planit rregullues..



- Hapësira në të hapur brenda parcelës së dhënë individuale (zona A, Fshati i Arbërisë) bazuar në kushtet e dhëna për ISH (indeks të shpunës së ndërtimit) duhet të jenë kualitative dhe të ofrojnë vende për aktivitete joformale si psh: vende për ulje, lojra fëmijësh, aktivitete familiare, etj. Këtu hyjnë kopshtet e përparme dhe të pasme, rrugët, trotoret, terasat, etj.
- Hapësira në të hapur brenda një bloku të banimit (zonat B, C, E) poashtu duhet të përmbajnë aktivitetet si të cekura më lartë, por që të përmbushin kërkesat e dendësisë më të madhe, përfshirë vendtakimet joformale, sheshet e vogla dhe shtigjet për shëti dhe vrapim rekreues. Radiusi i këtyre sipërfaqeve duhet të përmbyllë një tërësi urbane dhe duhet t'u shërbejë max. 5000 banorëve. Këto sipërfaqe duhet të dizajnohen me fleksibilitet të madh ashtu që të bëhet lidhja e sipërfaqeve të gjelbëruara para dhe prapa blloqeve të banimit duke rezultuar me sipërfaqe deri në max. 0.8 që poashtu derivon nga ISH i përvetësuar. Në kuadër të këtyre hapësirave inkurajohet edhe zhvillimi i fushëlojave përbrenda parqeve të vogla të tërësive.
- Hapësira në të hapur brenda zonës së Planit (bloku A3 dhe A4, B4 dhe E8) do të kenë funksionin si më lartë ku poashtu mund të parashifen sipërfaqet sportive për turnire dhe gara lokale, si fusha të futbollit, hapësira për lojë kreative, pishina në të mbyllur apo në të hapur, etj.. Këto sipërfaqe do të jenë në afërsi të shkollave fillore duke krijuar mundësinë për parqe lokale me ose kombinime park-shkollë.
- Hapësira në të hapur në Tërësinë D, Parku i qytetit' do të përfshijë aktivitete kulturore, edukative dhe fizike, aktivitete multi-disciplinare, si dhe hapësira për parqe argëtuese dhe hapësira për sporte të mëdha, për të gjithë banorët e Prishtinës. Kjo hapësirë duhet të jetë e arritshme përmes ecjes (për banorët e Arbërisë 3) si dhe me bicikleta dhe transport publik (për qytetarët e tjerë të lagjeve përreth dhe të gjithë qytetit). Brenda kësaj tërësie do të lejohen:
 - 1) Zhvillime të reja për qëllimet e dhëna:
 - Pyllëzim, shtigje për rekreim joformal
 - Objekte të sportit dhe të rekrimit
 - Hapësira për promovim dhe ngritje të vetëdijes lidhur me florën dhe faunën si auditoriume, kopsht botanik, akvarium, etj.
 - Objekte përcjellëse si hotel, motel, restoran, etj..
 - Hapësira për parkim në të hapur
 - 2) Ridestitim të objekteve ekzistuese me kusht që:
 - objekti të mos zgjerohet dhe që ridestinimi të ndërmerret ashtu që objekti të fitojë në formë dhe pamje të përgjithshme që i përshtatet rrethinës që ka,



- objekti të ridestinohet ashtu që të mos e cenojë karakterin e tërësisë së „Parkut të Qytetit“ ose përmbushjen e qëllimeve të tij;

Qarku i rekreimit Arbëria 3

Shiritat gjelbërues në funksion të ndërlidhjes së Arbëria 3 me Zonën Qendrore të Sportit dhe Rekreimit të Qytetit të Prishtinës – Stadiumi i qytetit dhe Palestra Sportive (Qendra e Rinisë) do të organizohen ashtu që të arrihet ndërlidhja e shpejtë për këmbësorët, nga qendra e qytetit, përkatësisht Stadiumi i qytetit, me Parkun e Qytetit. Rruga deri në Parkun e qytetit është paraparë që të krijohet përmes të një shiriti gjelbërues në të cilin do të kalojnë shtigjet këmbësorike duke e krijuar kështu qarkun e rekreimit të zonës Arbëria 3.

10.3. NDRIÇIMI RRUGOR DHE I ZONAVE TË SPORTIT – NDOTJA PËRMES NDRICIMIT

Ndricimi rrugor duhet të organizohet ashtu që të ofrohen kushte të përshtatshme për ndricim adekuat gjatë natës, e që nënkupton mbisundimin e territ dhe njëkohësisht uljen e ndotjes së panevojshme me ndricime të forta. Ndricimi i jashtëm në rastin e fundit mund të shkaktojë pengesa të shfrytëzuesit të rrugëve. Poashtu, efektet e ndricimit të tepuar, përveç që kanë implikime të shfrytëzimit joefikas të energjisë elektrike, mund të çojë në reflektim të qiellit gjë që pengon në sytë e njerëzve dhe cilësohet si ndotje vizuale.

Zona e Parkut të Qytetit (D) dhe parqet tjera locale (A4 dhe E8) përbrenda Arbërisë 3 duhet të sigurojë ndricim adekuat rrugor ashtu që të mos shkaktohet rrezik në rrugë si dhe shqetësime vizuale në zonë dhe përreth. Varësisht nga lokacioni i ngushtë i zhvillimeve të reja që implikojnë përdorim më të vecantë të ndricimit të jashtëm (reflektorë dhe ndricime tjera të forta), do të vendosen kushte lidhur me natyrën dhe intenzitetin e ndricimit si dhe lidhur me orarin e shfrytëzimit të tij.

10.4. MONITORIMI DHE MBROJTJA E MJEDISIT

Situata aktuale në Prishtinë nuk është e kënaqshme kur kemi të bëjmë me mbrojtjen e mjedisit. Shumë arsye që dalin nga e kaluara e afërt, përfshirë kapacitetet jokomplete të shërbimeve publike dhe njëkohësisht vetëdijësimi jo shumë i lartë i qytetarëve lidhur me pasojat e ndotjes së mjedisit të tyre, ka bërë që sot Prishtina të ballafaqohet me fenomene si deponi ilegale të hedhurve dhe aktivitete ekonomike të cilat potencialisht



e ndotin ujin, ajrin dhe tokën, pa qenë të verifikuara nga ana e institucioneve kompetente.

Një situatë e tillë kërkon intervenim të shpejtë në rrafshin e gjerë, ndërkaq lidhur me zonën e planit Regullativ Arbëria 3 kërkohet që qysh në fillim të konsiderohet një program për inkurajim të formave alternative të ngrohjes (e që implikon forma tjera pëveç djegies së linjtit), formë të organizuara të mbledhjes së hedhurinave (e që nënkupton alternativën e riciklimit të tyre përbrenda programeve ndërtimore dhe veprimtarive sekondare), automatizimi dhe transporti (e që nënkupton një program të përgjithshëm implementimnë e legjislacionit në fuqi lidhur me llojet e veturave që mund të kenë qasje në qytetin e Prishtinës, etj.

Në këtë vazhdë, monitorimi i vazhdueshëm i mjedisit nga ana e institucioneve gjegjëse do të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit të ndërtuar. Një sistem i kontrollit të vazhdueshëm, kërkesat për VNM nga ana e autoriteve komunale si dhe vetëdijësi i qytetarëve përmes procesit të edukimit janë parakushtet themelore për implementim efikas të Planit Regullativ Arbëria 3 në raport me mbrojtjen mjedisore të kësaj zone.

11. MASAT DHE INSTRUMENTET PËR REALIZIM



12. SHTOJCAT



12.1. SHTOJCA 1: KLASËT E DESTINIMEVE

KLASI "A"	Destinim primar – tregti/afarizem në kuadër të zonave të banimit
A1 Dyqanet e hapura për publik	a) dyqane për shitje të të mirave, me përjashtim të ushqimeve të ngrohta; b) zyra postale (posta të vogla); c) agjensitë turistike; d) kiosqet për shitjen e ushqimeve të ftohta; e) sallon ondulimi; f) prezentimi i të mirave për shitje (përfaqësi); g) huazimi /marja me qira e të mirave shtëpiake ose personale; h) lajra/pastrimi i rrobave/pëlhurave, pastrimi kimik; i) huazimi /marja e të mirave për larje, pastrim dhe servisim; j) menaxhimi i funeraleve;
A2 Shërbimet profesionale dhe Financiare	a) shërbimet financiare b) Shërbimet profesionale (me përjashtim të shërbimeve shëndetësore /mjekësore) c) Shërbime tjera të përshtatshme për zonë të shoppingut
A3 Ushqimi dhe pijet (gastronomia)	Shitja e ushqimit ose pijeve për konsumim në hapësirë ose të ushqimit të ngrohtë për konsumim jashtë hapësirës

KLASI "B"	Destinim primar – veprimtari ekonomike dhe afarizëm /tregti në kuadër të zonave ekonomike/afariste
B1 Biznesi - me kusht që destinimi të mund të ekzistojë në zona banimi pa pasur ndikime negative në kontekstin e mjedisit të pastër dhe ekologjik.	(a) zyrat, në përjashtim të destinimeve të cekura në Klasin A2 (b) hulumtimet dhe zhvillimet e produkteve apo proceseve ekonomike/komerciale (c) Sallonet e veturave
B2 Furnizim/shërbim	(a) Pompat e benzinës (b) Zyrat për huazim të veturave dhe për taksitë shërbim



KLASI C	Destinim primar –rezidenca/institucione rezidenciale
C1 Hotelet, motelet	Hotel, motel, shtëpi për mysafirë, ku në cilindo rast nuk ofrohet përkujdesi i nivelit të lartë
C2 Institucionet rezidenciale	Akomodimet rezidenciale dhe kujdesi për njerëzit (të gjithat përvec destinimt të klasit C3) ; Spitalet ose shtëpitë e pleqëve qendrat rezidenciale të trajnimit, qendrat rezidenciale në shkolla
C3 Njësi e banimit (rezidenciale)	(a) shtëpitë familiare (b) banim kolektiv (blloqe banimi)

KLASËT	Destinim primar –institucione jorezidenciale, vende publike
D1 Institucionet jo rezidenciale	(a) shërbimet medikale/shëndetësore përvec të atyre që ndodhen brenda banesës së punëtorit shëndetësor (b) përkujdesi ditor (cerdhet, kopshtet e fëmijëve) (c) arsimi (shkollat) (d) Muzetë (e) Bibliotekat publike, dhomat e leximit (f) Sallat publike, sallat e ekspozitave (g) Objektet religjioze
D2 Vendet publike të argëtimit/rekreimit	(a) Kinematë, teatri (b) Salla e koncerteve (c) Salla të vallëzimit (diskotekat) (e) sallat e fiskulturës, pishinat, zonat e rekreimit brenda dhe jashtë (f) Lunaparqet, Parqet e argëtimit
D3 Shërbimet komunale/publike	(a) administrata komunale / qendra e komuniteteve (b) shërbimi i zjarrfikësve (c) shërbimi policor



12.2. SHTOJCA 2: MODELET E PLANIFIKIMIT URBAN



Fig. 1. Modeli I Rregulimit

1. MODELET E STRUKTURAVE URBANE

Shembull: Veranda e Arbërisë 3.

Modalitetet e shfrytëzimit të parcelave prej 30% deri në 60% si dhe mënyra e ndarjes së sipërfaqeve publike nga strukturat e ndërtuara.

Shembulli i shtrirjes paralele me rrugën Tirana/trenin urban.






Figure 2. . Modeli I Regulimit

2. MODELET E STRUKTURAVE URBANE - Detal:

Shembull: Veranda e Arbërisë 3.

Modaliteti I organizimit të strukturave terrasore (përshtatja maksimale në pjerrtësinë e terrenit) për rastin e shfrytëzimit të parcelave ca 50% , si dhe mënyra e komunikimeve vertikale-horizontale për këmbësorët (shkallët, sheshet publike)

Shembulli i shtrirjes tërthore me rrugën Tirana/trenin urban.

